UDHËZIM
Nr.7, datë 8.11.2006

PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT DHE RUAJTJEN E TË DHËNAVE PËR NDËRTIMET PA LEJE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 2 të nenit 12 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje",

UDHËZOJ:

1. Përzgjedhja dhe mbledhja e të dhënave për ndërtimet pa leje

a) Njësia e qeverisjes vendore, për të realizuar përzgjedhjen dhe mbledhjen e të dhënave të nevojshme për procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, shfrytëzon:

i) të dhënat e përftuara nga/gjatë etapës së vetëdeklarimit;

ii) të dhënat e përftuara nga/gjatë etapës së identifikimit në terren;

iii) të dhënat e përftuara nga/gjatë etapës së plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor.

b) Këto të dhëna kanë të bëjnë me vetëdeklaruesin e ndërtimit pa leje, ndërtimin/objektin pa leje dhe me parcelën ndërtimore.

c) ALUIZNI përpunon të dhënat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes vendore, të cilat do të shërbejnë për monitorimin, realizimin e procesit të legalizimit, regjistrimin fillestar të ndërtimeve pa leje, kompensimin dhe për urbanizimin e integrimin e territoreve informale.

d) Me të dhënat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes vendore gjatë etapave të ndryshme, ALUIZNI do të krijojë bazën e të dhënave (*data base*) të procesit të legalizimit.

2. Të dhënat e përftuara nga/gjatë etapës së vetëdeklarimit

Nga regjistri i të dhënave të formularëve "Vetëdeklarim për legalizim objekti" (A dhe A1), i cili përbën një bazë të rëndësishme të dhënash për vazhdimësinë e procesit, njësia e qeverisjes vendore selekton dhe shfrytëzon këto elemente:

a) numrin e dosjes së vetëdeklarimit të ndërtimit pa leje, i cili është numër unik brenda bashkisë/komunës dhe do të shërbejë si element identifikues për objektin deri në përfundim të procesit;

b) emrin, atësinë dhe mbiemrin e plotë të vetëdeklaruesit;

c) datën e vetëdeklarimit, e cila do të shërbejë për përcaktimin e sanksioneve financiare të zbatueshme për etapën e vetëdeklarimit.

3. Të dhënat e përftuara nga/gjatë etapës së identifikimit në terren

a) Grupet e punës të ngritura nga njësia e qeverisjes vendore, përmes hartimit të procesverbalit të konstatimit, saktësojnë dhe grumbullojnë në terren të dhëna reale për gjendjen ndërtimore të objekteve dhe gjendjen e parcelave ndërtimore.

Këto të dhëna janë:

i) sipërfaqja e parcelës ndërtimore;

ii) sipërfaqja totale e ndërtimit;

iii) sipërfaqja e bazës së objektit;

iv) numri i kateve të objektit pa leje;

v) funksioni i hapësirave të objektit pa leje;

vi) qëllimi i shfrytëzimit të objektit pa leje (qiradhënie/shitblerje);

vii) kualifikimi paraprak për ndërtimet pa leje (vazhdojnë procedurat e legalizimit/nuk legalizohen/pezullohen);

viii) data e identifikimit në terren.

b) Të dhënat e grumbulluara do të paraqiten në formë tabelore (tabela nr.1 bashkëngjitur këtij udhëzimi) dhe plotësimi i saj do të realizohet sipas grupimevezonë /vendbanim/ bllokbanim /ndërtim informal dhe territore të tjera, si dhe për shtesat pa leje në objekte me leje.

c) Përpunimi i të dhënave të përfituara nga tabela nr.1 dhe nga hartat dixhitale, produkt i fotografisë ajrore, do të shërbejnë për hartimin dhe përputhjen e plotë të parcelave ndërtimore

(genplaneve).

4. Të dhënat e përftuara pas vendimmarrjes në KRRT / KRRTRSH

Këto të dhëna kanë të bëjnë me:

a) emërtimin e territorit informal;

b) kualifikimin e objekteve për legalizim (po, jo, pezullohen);

c) ridimensionimin e sipërfaqeve të parcelave ndërtimore dhe/ose sipërfaqes së ndërtimit.

5. Të dhënat e përftuara përmes procedurave për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor

a) Gjatë plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, njësia e qeverisjes vendore grumbullon të dhënat e mëposhtme:

i) numrin e zonës kadastrale;

ii) numrin e pasurisë;

iii) adresën e plotë të pasurisë (qarku, qyteti/fshati, rruga/lagjja, pallati/godina, shkalla/kati, apartamenti);

iv) sipërfaqen e parcelës ndërtimore;

v) sipërfaqen totale të ndërtimit;

vi) sipërfaqen e bazës së objektit;

vii) dokumentin me të cilin gëzon/fiton pronësinë mbi tokën (ligj, vendim, kontratë, trasaksion etj.);

viii) pjesëmarrjen në bashkëpronësi;

ix) vlerën e paguar për parcelën ndërtimore.

b) Të dhënat e grumbulluara do të pasqyrohen në tabelën nr.2 bashkëngjitur këtij udhëzimi, me përjashtim të rubrikës “Kufizimet D/E”. Këto të dhëna, së bashku me ato të përftuara nga leja e legalizimit, do të shërbejnë për regjistrimin fillestar të pasurisë.

6. Administrimi dhe ruajtja e të dhënave të grumbulluara

a) Të gjitha të dhënat e përmendura në këtë manual do të plotësohen, administrohen dhe ruhen nga njësitë e qeverisjes vendore, në formë dixhitale (*cd*) dhe shkresore (*hard coppy*).

b) Të dhënat duhet të jenë të sakta, të plota dhe nuk mund të përdoren për qëllime që nuk janë parashikuar në këtë udhëzim.

c) Informacioni për ecurinë do t’u përcillet në mënyrë periodike drejtorive rajonale të ALUIZNI-t.

d) Njësitë e qeverisjes vendore, të dhënat përfundimtare sipas zonimeve do t’ia përcjellin drejtorive rajonale të ALUIZNI-t, në dy kopje, në formë dixhitale (*cd*) dhe shkresore (*hard coppy*). Materialet shkresore duhet të mbajnë firmën e kryetarit dhe vulën e njësisë së qeverisjes vendore.

e) Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t krijon sistemin e saj të përpunimit dhe administrimit të të dhënave, që do të shërbejë për legalizimin e objekteve pa leje dhe për regjistrimin fillestar, si dhe për ecurinë e të gjitha etapave të procesit.

f) Hartat dixhitale, produkt i fotografimit ajror, së bashku me infomacionet e mbledhura gjatë etapave të ndryshme, janë të dhënat bazë që do të shërbejnë për realizimin e procesit të legalizimit, regjistrimit fillestar, urbanizimit dhe integrimit të territoreve me ndërtime pa leje.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Lulzim Basha

TABELA Nr.1

Qarku_____ Bashkia/Komuna_____ Fshati/Rajoni _____

Zona _____

Nr.	Nr. i dosjes	Emër	Atësi	Mbiemër	Data e vetdeklarimit	Sipërfaqjet			Nr.kateve	Funksioni/Qëllimi			Data e identifikimit në terren	Kualifikimi paraprak
						parcela	ndërtimi	baza		banesë	funksion social-ekonomik	e kombinuar		
1														
2														
3														
4														
5														
6														
7														
8														
9														
10														
11														
12														
13														
14														
15														
16														
17														
18														
19														
20														
21														
22														
23														
24														
25														
26														
27														

Për Njësinë e Qeverisjes Vendore